

5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME

URDHËR
I
PROKURORIT TE PËRGJITHSHËM
Nr. 10 Date. 23.01.2001

Sot me date 23.01.2001, unë Arben Rakipi, Prokuror i Përgjithshëm i Republikës, me qëllim për të bërë efektiv zbatimin e ligjit Nr. 8677, date 2.11.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore", për të nxitur krijimin e seksioneve efikase pranë prokurorive, për të shtuar interesin e oficerëve të policisë të seksioneve për hetimin dhe zbulimin e veprave penale, për të bërë një ndarje të qartë të çështjeve me të cilat do të merren ata, bazuar në nenin 24 të K.Pr.Penale

URDHËROJ

1. Prokuroret të marrin të gjitha masat për kuptimin dhe funksionimin e drejtë të ligjit për policinë gjyqësore.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, hetimet do të zhvillohen nga oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve të prokurorisë, të ardhur në këtë seksion nga policia që ka bërë hetimin apo kallëzimin.

3. Të bëhet kujdes në respektimin e normave të K.Pr.Penale, të afateve të kryerjes së veprimeve, dhe cilësisë së tyre.

4. Oficerët juristë të policisë gjyqësore, pranë seksioneve të prokurorisë, të emëruar në punë nga Prokurori i Përgjithshëm, tu delegohen për hetim çështje të filluara kryesisht që nuk kanë lidhje në përmbajtjen e tyre me ndonjë nga aktivitetet e policive të pranishme me oficerë në seksionet e prokurorive,

çështje të ardhura me denoncim në prokurori nga institucione që nuk kanë polici të tyre; çështje në të cilat policia mund të jetë vetë e implikuar (në këtë rast me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm) si dhe kallëzimet nga shtetasit që nuk lidhen domosdoshmërisht me nevojën e kryerjes së veprimeve nga ana e policisë.

5. Në rastet kur ngarkesa e punës së oficerëve të policisë gjyqësore të një seksioni është e ndryshme dhe e pabarabartë, prokurori i rrethit mund të formojë grupe hetimi të përbashkëta me të gjitha llojet e oficerëve që disponon seksioni.

6. Në çështje të rëndësisë së veçantë, lidhur me turbullime të rënda të rendit publik, krim të organizuar apo kur shihet e nevojshme nga prokurori i rrethit, të përfshihen në grupet e hetimit edhe oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve të policisë.

7. Ky urdhër tu shpërndahet të gjitha prokurorëve të rretheve, Apeleve dhe prokurorëve në Prokurorinë e Përgjithshme.

8. Një kopje ti dërgohet Ministrisë së Rendit Publik, të Financave, dhe Bujqësisë për tua bërë të njohura policive në strukturat e tyre.

9. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORI I PËRGJITHSHEM

ARBEN RAKIPT



